



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:119070

Datë: 17.07.2020

Numri i dokumentit: 01028681

**P.nr. 530/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM**, me gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit, S. M., për shkak të veprës penale, **lidhje e paaautorizuar e shërbimeve**, parashikuar nga neni 314 te KPK-së, e sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/II.nr. 1172/2019, të dt. 31.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të dt. 29.06.2020, në prezencë të Prokurorit të shtetit Lumturije Vuçetaj, të pandehurit S. M., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.14.07.2020, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I pandehuri,**

**S. M.**, i lindur me dt. ..., , K. Pejë ku edhe banon i biri i B. dhe nënës Z., e gjinisë B., identifikohet në bazë të Inj.nr. personal ..., ka te kryer shkollën e mesme, pensionist, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Për shkak se:**

Me dt. 20.10.2017, K- Pejë saktësisht ne objektin e tij familjar siguron shërbime për te cilat dihet se mundësohen vetëm ne shkëmbim te kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime te tilla, në atë mënyrë qe gjate një kontrolli te bere nga ekipi i kompanisë ““K...”” rezulton se i pandehuri shfrytëzon energjinë elektrike ne njehsorit te pa dhe pas hapjes e kapakut te njehsorit është vërejtur se L2 dhe 13 ishin te bashkuar dhe hyrje dalje ishin te bllokuar ashtu qe energjia e shpenzuar nuk është regjistruar me ç’ rast ndërmarrjes së dëmtuar ““K...””, Distrikti në Pejë , i shkakton dëm material ne lartësi prej 278.32 euro,  
-me çka ka kryer vepër penale, **lidhje e paaautorizuar e shërbimeve** , parashikuar nga neni 314 te KPK-së

Andaj, gjykata konform nenit 2, 7,21, 38,40, 42, 43, 59, 69, 70, 71, 72 par 1 nën par 1.6 dhe nenit 314 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin e:

## **G J Y K O N**

### **DËNIM ME BURG DHE GJOBË ME KUSHT**

-Dhe atë në kohëzgjatje burgimi prej 3(tre) muaj dhe me gjobë në shumen prej 300 (treqind) euro. Denimi me burg dhe me gjobë fare nuk kane per tu ekzekutuar, nëse i pandehuri ne afat prej 1 (nje) viti nuk kryen veprë te re penale.

-I pandehuri URDHËROHET, që palës se dëmtuar “K...”-it t’ia kompensoj shumen ne vlere prej 278.32 (dyqind e shtatëdhjetë e tete euro e tridhjetë e dy centë ), dhe atë në afat deri ne 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

-I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale në shumen prej 30 (tridhjetë) euro dhe të paushallit gjyqësor në shumen prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 1172/2019, të dt. 31.05.2019, kundër të pandehurit S. M., për shkak të veprës penale lidhje e paaautorizuar e shërbimeve nga neni 314 te KPK-së,

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 29.06.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe bazuar ne dispozitën e nenit 244 të KPP-së, është konstatuar prezenca e prokurorit të shtetit, dhe të pandehurit.

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta, dhe ka deklaruar se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit qe të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka shprehur pendim për veprën e kryer dhe dëmin e shkaktuar është duke e paguar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe pa kurrfarë presioni.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: procesverbali me nr. 2298798 të dt. 20.10.2017 ku është konstatuar se ekipi është hasur ne njehsor te pa bllombuar ku pas hapjes se kapakut te njehsorit ehte vërejtur L2 dhe l3 ishin te bashkuara qe do te thotë se hyrja dalja ishin bere bashke , faturave se rikthimit te humbjeve nr. DPE17HP1711388 të dt. 30.10.2017, cilën është konstatuar se i pandehuri e ka dëmtuar kompaninë e lartcekur ne shume prej 278.32 euro , si dhe foto- albumi nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat tjera të lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit S. M., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale lidhje e paautorizuar e shërbimeve nga neni 314 te KPK-së,

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer dhe premtimin se në te ardhmen nuk do te kryej vepra penale, e po ashtu edhe faktin se i pandehuri tani është duke e paguar demin e shkaktuar palës se dëmtuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata urdhëroi kompensimin e te dëmtuarës ne shume prej 278.32 (dyqind e shtatëdhjetë e tete euro e tridhjetë e dy) centë, nga ana e të pandehurit pasi që aktgjykimi ta merr formën e prerë e mori ne përputhje me nenin 61 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 dhe 2.7 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet gjyqësore shume prej 30 (tridhjetë) euro dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
P.nr.530/19 dt. 14.07.2020**

**Bashkëpunëtorë profesionale**

**Gjyqtari**

\_\_\_\_\_

**Selvane Bukleta**

\_\_\_\_\_

**Dr. Sc. Murat Hulaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.